



# Dokument politikash

## Lufta kundër pastrimit të parave – Roli i shoqërisë civile

No. 01 | Korrik 2021

Autor: Gjergji Vurmo

Lufta e institucioneve ligjzbatuese ndaj grupeve kriminale dhe sfida të tjera “tradicionale” apo bashkëkohore sugjerojnë se kapacitetet KPP / KFT të organeve shtetërore kanë nevojë për më shumë mbështetje, aftësi të reja, këndvështrime të thelluara analitike dhe burime alternative njohurish.

## Konteksti

Pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit nuk janë tema të padëgjua nga shoqëria civile, rrethet akademike e sidomos nga media në Shqipëri. Ndërkohë që kjo e fundit (media) ka raportuar shpesh lidhur me këtë fenomen<sup>1</sup>, studiuesit e fushës së drejtësisë dhe ekonomisë i kanë trajtuar të dyja temat ndonëse këtë e kanë bërë më pak nëpërmjet nismave hulumtuese. Shoqëria civile nga ana tjetër ka qenë më pasive

lidhur me fenomenin dhe masat kundër pastrimit të parave (KPP), apo ato kundër financimit të terrorizmit (KFT). Konceptet e KPP / KFT, përveç disa organizatave studimore në fushën e sigurisë, antikorrupsionit<sup>2</sup> apo parandalimin e ekstremizmit, për shumicën e aktorëve të shoqërisë civile u bënë të njohura disa vite më parë kur Shqipëria ndërmori hapa shtesë për të përmbushur standardet e Rekomandimit 8 të Task Forcës për Veprime Financiare (FATF – Financial Action Task Force). Konkretisht, ky

<sup>1</sup> Shih “Brenda kartelit të parë shqiptar të trafikimit ndërkombëtar të kokainës” Elton Qyno 18 shkurt 2021, Reporter.al. Burimi: <https://www.reporter.al/brenda-kartelit-te-pare-shqiptar-te-trafikimit-nderkombetar-te-kokaines/>

<sup>2</sup> Shih “Zbërthimi i kapjes së shtetit në Shqipëri: Një shqyrtim i rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë dhe ligjeve të bëra me porosi nga viti 2008 deri në 2020”, IDM dhe Transparency International, Mars 2021. Burimi <https://idmalbania.org/sq/zberthimi-i-kapjes-se-shtetit-ne-shqiperi/>.

rekomandim u sugjeron vendeve anëtare të FATF të përmirësojnë kuadrin ligjor për organizatat jo-fitimprurëse në mënyrë që të parandalohet keqpërdorimi i tyre për qëllime të financimit të terrorizmit<sup>3</sup>. Më tej, çështja e pastrimit të parave u trajtua më shpesh në diskursin publik dhe të raporteve të ndryshme studimore<sup>4</sup> kryesisht në kontekstin e konfiskimit të aseteve dhe të ardhurave të paligjshme të krijuara nga krimi i organizuar.

Ndërkohë, mbetet ende për t'u ekzaminuar më tej pastrimi i parave në kontekstin e korrupsionit të lartë dhe kapjes së shtetit, raportimeve të shtuara mbi krimin e organizuar, gërshetimin e interesave ilegjitime në politikë, ekonomi dhe më gjerë. Lufta e institucioneve ligjzbatuese ndaj grupeve kriminale dhe sfida të tjera "tradicionale" apo bashkëkohore (p.sh. kriptomonedha) sugjerojnë se kapacitetet KPP / KFT të organeve shtetërore kanë nevojë për më shumë mbështetje, aftësi të reja, këndvështrime të thelluara analitike dhe burime alternative njohurish.

## “Monopoli shtetëror” i luftës KPP – Çfarë po ndryshon?

Pikëlidhja e parë që parashtrohet rëndom ndaj rolit të shoqërisë civile në luftën kundër pastrimit të parave është Rekomandimi 8 i FATF – i cili e trajton shoqërinë civile si një nga sektorët e riskut për financimin e terrorizmit, për të cilin vendet anëtare janë këshilluar të marrin masa ta parandalojnë. Për një kohë të gjatë edhe praktika e vendeve më të avancuara në luftën kundër pastrimit të parave ka mbetur e kufizuar në këtë rol të shoqërisë civile. **Por përtej të qenurit sektor risku në kuadër të legjislationit të parandalimit të pastrimit të parave**, shoqëria civile ka një potencial ende të pashfrytëzuar plotësisht në parandalimin e fenomenit. Konkretisht, puna hulumtuese e sektorit të medias, shpesh në bashkëpunim edhe me aktorë të shoqërisë civile – si *Panama Papers*, *FinCen*, *Swiss leaks* etj. – jo vetëm ka impaktuar anën përmbajtësore të rekomandimeve të FATF duke sjellë qasje të reja p.sh. ndaj koncepteve si '*beneficial ownership*' (pronarët përfitues), por ajo

<sup>3</sup> Këto masa u pritën me mosbesim nga shoqëria civile çka pjesërisht i detyrohej edhe mungesës së konsultimit me aktorët e sektorit. Aktualisht e njëjta qasje është prezente edhe me ndryshimet e reja për projektligjin e regjistrimit të OJF-ve ku shoqëria civile i ka bërë thirrje Kuvendit të kërkojë opinionin e Komisionit të Venecias. Shih për më shumë <https://resourcecentre.al/2021/04/19/networking-event-the-sustainability-of-youth-organizations-in-the-pandemic-and-post-pandemic-period/>

<sup>4</sup> Shih "Illicit financial flows in Albania, Kosovo and North Macedonia - Key drivers and current trends", Global Initiative against Transnational Organized Crime, 2020. Burimi <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2020/08/Illicit-Financial-Flows-in-Albania-Kosovo-and-North-Macedonia-Key-drivers-and-current-trends.pdf>.

po ashtu ka ndikuar edhe praktikën e bashkëpunimeve dhe rolin e aktorëve të tjerë të cilët mund të kontribuojnë me kapacitete, aftësi apo evidenca në luftën KPP / KFT në nivel global. **Në shumë vende nënshkruese të FATF, shoqëria civile dhe rrethet akademike e kanë provuar veten si një aset, më shumë sesa si një sektor risku apo si një subjekt i thjeshtë raportimi. Kjo tendencë duket se po formësohet edhe në Shqipëri, ku ky dokument dhe aktiviteti prezantues i tij<sup>5</sup> synojnë t'i përgjigjen kësaj sfide.**

Në fakt, një seri takimesh të IDM me përfaqësues të agjencive qeveritare dhe institucioneve të pavarura shtetërore të përfshira në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, rretheve akademike, shoqërisë civile, medias, dhe përfaqësuesve të partnerëve ndërkombëtarë prezentë në Shqipëri **konfirmuan nevojën për një përfshirje më aktive të shoqërisë civile dhe rretheve akademike<sup>6</sup>. Kjo nevojë më tej mbështetet edhe në faktin që shoqëria civile dhe academia, së bashku ose edhe individualisht, kanë zhvilluar tashmë kapacitete dhe nisma konkrete të cilat kontribuojnë në ekspozimin e mekanizmave dhe të dhëna të tjera lidhur me fenomenet e burimit të**

**pastrimit të parave – konkretisht të krimit të organizuar dhe aktiviteteve të paligjshme, korrupsionit dhe kapjes së shtetit, ekstremizmit të dhunshëm që çon në terrorizëm** etj. Këto kapacitete tashmë mund të aftësohen më tej për t'u shfrytëzuar në luftën KPP / KFT dhe për të rritur efikasitetin dhe cilësinë e masave për parandalimin e pastrimit të parave. Janë të shumta rekomandimet e FATF ku kapacitetet dhe burimet e shoqërisë civile, medias dhe rretheve akademike, si edhe vlera e shtuar që gjenerohet nëpërmjet sinergjive të tyre të përbashkëta edhe me institucione shtetërore mund të gjejnë vend më së miri. Sa për ilustrim, përtej rolit dhe obligimeve tona në kuadër të Rekomandimit 8, rekomandime të tjera të FATF përfshijnë rekomandimin 12 (personat e ekspozuar politikisht), rekomandimi 15 (teknologjitë e reja), rekomandimet 22 dhe 23 (*DNFBPs - Bizneset dhe profesionet jo-financiare të përcaktuara*), apo rekomandimet 24 dhe 25 (transparenca dhe pronarët përfitues) etj.

Së fundmi, masat e institucioneve shtetërore për parandalimin e pastrimit të parave kanë nevojë edhe për një dimension më thelbësor të llogaridhënies publike (*accountability*) i cili mund të

<sup>5</sup> *Forumi “Lufta kundër pastrimit të parave në Shqipëri – Çfarë roli për shoqërisë civile?”* (25 Qershor 2021).

<sup>6</sup> Gjatë periudhës prill – maj 2021, IDM ndërmori disa takime në funksion të përgatitjes së Forumit “Lufta kundër pastrimit të parave në Shqipëri – Çfarë roli për shoqërisë civile?” (25 Qershor 2021) dhe për të prezantuar programin e ri të IDM në fushën e parandalimit të pastrimit të parave.

Takimet u zhvilluan me përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Ministrisë së Brendshme, Bankës së Shqipërisë, ILDKPI, Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare, institucioneve ligjzbatuese etj. si edhe me aktorë të shoqërisë civile, medias, donatorë dhe partnerë ndërkombëtarë prezentë në Tiranë.

mundësohet nga bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe zgjerimi i përfshirjes së saj dhe i rretheve akademike në këtë fushë. Aktualisht ky dimension është i mjegullt dhe shoqëria civile është një prej sektorëve që është përballur me pasojat e veprimeve që e kanë vendosur shoqërinë civile para një fakti të kryer siç janë ndryshimet e fundit ligjore në ligjin për regjistrimin e OJF-ve. Edhe më herët, ndryshime ligjore që kanë prekur procedurat e raportimit financiar të OJF-ve dhe aspekte të tjera të operimit të organizatave të shoqërisë civile janë kryer jo vetëm pa konsultimin e sektorit, por shpesh edhe pa e informuar atë mjaftueshëm.

## Shoqëria civile si partner i autoriteteve në luftën kundër pastrimit të parave – Rekomandime për veprim

<sup>7</sup> Shih Carbis Bay G7 Summit Communiqué, 11-13 Qershor 2021, faqe 19 “..dhe të njihet nevoja për aksione kundër korruptionit, përfshirë këtu ndarjen e informacionit mbi aktivitetet financiare të paligjshme, trajtimin e keqpërdorimit të kompanive guackë dhe kufizimin e aftësisë së aktorëve të paligjshëm për të fshehur pasurinë, përfshirë këtu edhe pasuritë e paluajtshme.”  
Burimi  
<https://www.consilium.europa.eu/media/50361/carbis-bay-g7-summit-communication.pdf>. Më herët edhe SHBA e kanë shpallur luftën kundër

Lufta kundër pastrimit të parave gjithnjë e më shumë po priorizohet si shënjestër jo vetëm krimin e organizuar (KPP), grupet ekstremiste dhe terroriste (KFT), por gjithashtu edhe korrupsionin dhe grupet e fuqishme që gërshetojnë interesa ilegjitime politike dhe ekonomike në aksionin e tyre për kapjen e shtetit dhe sigurimit të mjeteve dhe mekanizmave të reja për pastrimin e parave<sup>7</sup>. Parandalimi dhe adresimi i korrupsionit njihet si një prioritet i rëndësishëm i liderëve të G7 në Deklaratën e tyre mbi Shoqëritë e Hapura ku ata theksojnë:

*Ne jemi në një moment kritik, ku po përballemi me kërcënime të ndryshme ndaj lirisë dhe demokracisë; nga autoritarizmi në rritje, ndërhyrjet elektorale, korrupsioni, shantazhi ekonomik, manipulimi i informacionit, përfshirë dezinformimin, krimet dhe sulmet kibernetike, bllokimet politikisht të motivuara të faqeve të internetit, shkeljet dhe abuzimet e të drejtave të njeriut, terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm<sup>8</sup>.*

korruptionit të një interes kombëtar thelbëso. Shih Memorandumin e Shtëpisë së Bardhë datë 3 Qershor 2021

<https://www.whitehouse.gov/briefing-room/presidential-actions/2021/06/03/memorandum-on-establishing-the-fight-against-corruption-as-a-core-united-states-national-security-interest/>

<sup>8</sup> Burimi

<https://www.consilium.europa.eu/media/50364/g7-2021-open-societies-statement-pdf-355kb-2-pages.pdf>.

Shoqëria civile, media dhe rrethet akademike kanë ndërtuar një përvojë të vlerësueshme hulumtimi, informimi, ndërveprimi dhe investigimi të fenomeneve të tilla të cilat prodhojnë “ofertën” për pastrimin e parave. Shfrytëzimi i kapaciteteve dhe eksperiencës së tyre i ofron autoriteteve shtetërore dhe përpjekjeve KPP / KFT një vlerë të shtuar dhe përparësi krahasimore të qenësishme. Megjithatë, **përfshirja e shoqërisë civile dhe rretheve akademike kërkon bashkëpunimin e një sërë aktorësh dhe një kuadër masash për të maksimizuar ndikimin dhe vlerën e shtuar të përfshirjes**. Rekomandimet e mëposhtme janë një pjesë e këtyre masave të cilat duhen ndërmarrë në mënyrë të koordinuar me **shoqërinë civile nga vendim-marrësit**, institucionet e përfshira në luftën KPP / KFT dhe institucionet **donatore** që mbështesin veprimtarinë e shoqërisë civile:

- Institucionet shtetërore duhet të zbatojnë sa më gjerë dhe në mënyrë përmbajtësore **qasjen bashkëpunuese me aktorë të shoqërisë civile** jo vetëm për të informuar, por edhe për të konsultuar dhe reflektuar sugjerimet e OJF-ve në masat legislative, institucionale dhe të plan veprimit të vendit për të avancuar në parandalimin e pastrimit të parave.

**Forcimi i dimensionit të llogaridhënies publike** nga ana e institucioneve shtetërore duhet të gjejë zbatim edhe në kontekstin e këtij bashkëpunimi.

- Shoqëria civile duhet të ndërtojë **kuptueshmëri më të plotë mbi**

**fenomenin** e pastrimit të parave dhe të kërkojë **të përfshihet në proceset vlerësuese dhe monitoruese** nga ana e MONEYVAL për Shqipërinë.

- Shoqëria civile duhet të investojë në **bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe ndërtimin e sinergjive me aktorët e tjerë si media dhe rrethet akademike** në fushën e parandalimit të pastrimit të parave. **Forcimi i kapaciteteve** të ndërsjellta dhe avancimi i kontributit të **nismave të përbashkëta** duhet të udhëhiqen nga evidencat dhe vlerësimet e thelluara të fenomenit.

- Institucionet donatore të shoqërisë civile duhet të **rrisin mbështetjen për aksione në fushën e parandalimit të pastrimit të parave në drejtim të kapaciteteve, informimit publik dhe të sektorëve të rrezikuar, si edhe hulumtimit** të fenomenit dhe praktikave / modeleve të suksesshme në luftën KPP / KFT.

- Së fundi, shoqëria civile duhet të nxisë krijimin e një **komiteti multiaktorial** me pjesëmarrjen e **shoqërisë civile, sektorit privat, universiteteve, medias** investigative, institucioneve **shtetërore** të përfshira në luftën kundër pastrimit të parave me qëllim **konsultimin periodik, forcimin e llogaridhënies dhe vlerësimin e progresit dhe sfidave** të vendit për të luftuar e parandaluar pastrimin e parave. Kjo strukturë duhet të udhëhiqet nga një sekretariat i cili i njej rol të qenësishëm aktorëve jo-shtetërorë.



Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim — IDM është një organizatë jo-qeveritare, e themeluar në nëntor të vitit 1999, që ka në fokus të veprimtarisë së vet qeverisjen pjesëmarrëse dhe institucionet demokratike, procesin e integritit në Bashkimin Evropian, zhvillimin e shoqërisë civile, bashkëpunimin rajonal dhe çështjet e sigurisë. Ne synojmë konsolidimin e zhvillimeve në këto fusha nëpërmjet hulumtimit të pavarur, rritjes së kapaciteteve dhe ndërveprimeve efikase përmes spektrit të gjerë të aktorëve në shoqëri.

Rr. Shenasi Dishnica, Nd. 35, H.1, 1017, Tirana | T +355 4 240 0241 | [info@idmalbania.org](mailto:info@idmalbania.org)



[/company/idm-albania](https://www.linkedin.com/company/idm-albania)



<http://www.idmalbania.org/>



[/idm\\_albania](https://twitter.com/idm_albania)



[/IDMAbania](https://www.facebook.com/IDMAbania)



Ky dokument politikash i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) është prodhuar në kuadër të projektit: "Platforma e Politikave: Ecja përpara në axhendën e integritit të Shqipërisë në BE" mbështetur nga Fondacioni Hanns-Seidel.

Faktet dhe opinionet e shprehura në këtë publikim janë të IDM dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe mendimet e Fondacionit Hanns-Seidel, i cili nuk mban përgjegjësi për to dhe përdorimin e tyre të mëtejshëm. Përgjegjësia e vetme është e autorëve të studimit.